



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 9.11.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N302

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selvije Halimi dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Danush Ademi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Enver Hoti.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu – EUSR/EV Office.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
3. Amendamentimi i Rregullores së Kuvendit;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Armend Zemaj, kryetar, tha se tanimë kemi një përfundim të Kryesisë, ku është kërkuar nga Komisioni për Legjislacion, që ta rishikojë tekstin e Projektligjit për Kuvendin. Në takimin e fundit të Komisionit, u kërkuar nga Nënkomisioni, që të veprojë në pajtim me Përfundimin e Kryesisë. Pra, kjo është edhe arsyeja e thirrjes së këtij takimi. Sa i përket Projektligjit për Kuvendin, vlerësoi se duhet mbajtur një takim me Kryetarin e Kuvendit, në mënyrë që të

orientohemi sesi do të punojmë, që mos të humbim kohë të panevojshme në hartim, nëse nuk ka vullnet për procedim. Ju e dini që ky projektligj prek në 5 ligje bazike, si: Ligjin për deputetë, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, Ligjin për prokurimin publik, Ligjin për shërbimin civil dhe Ligjin për pagat e nëpunësve civilë. Andaj, kemi bërë përpjekje të gjejmë mënyrën e shmangies së kontradiktave. Duke pasur parasysh këto ligje, si komision, kemi përgatitur draftin të cilin edhe e kemi proceduar për mendim në Qeveri dhe tani kemi edhe mendimin e Qeverisë për këtë projektligj. Në këtë fazë, duhet një takim me Kryetarin e Kuvendit, para se të punojmë në një draft tjetër. Po ashtu, na duhet kohë dhe marr për obligim që me sekretarinë e komisionit, ta përgatisim agjendën e radhës dhe të shikohet mundësia që të bëjmë edhe ndonjë vizitë jashtë vendit, sepse ju e dini që e kemi anuluar vizitën në Hungari, për shkak të zhvillimeve të fundit në Kuvend.

Selvije Halimi, tha se ne e kemi përfunduar punën në një draft dhe tani kur është kërkuar që të rishikohet ky draft nga Kryesia, vlerësoj se duhet të konsultohemi me grupet parlamentare se a duam ta kemi ligj për Kuvendin apo jo, në mënyrë që mos të bëjmë punë së koti. Edimë që ka pasur një takim të Kryetarit të Kuvendit me shoqërinë civile, por nuk e dimë se çka ka dalë nga ai takim. Po ashtu, do ishte mirë që të kemi konsultime shtesë dhe informata shtesë se sa shtete në rajon kanë ligj për Kuvendin dhe si funksionojnë. U pajtua me parafolësin, që të ketë një takim me Kryetarin e Kuvendit, që të dimë nga ta orientojmë punën.

Në fund të takimit, ishte një pajtim i përgjithshëm që të mbahet një takim me Kryetarin e Kuvendit dhe grupet parlamentare, para se të fillohet me hartimin e draftit të ri të Projektligjit për Kuvendin.

3. Amendamenti i Rregullores së Kuvendit

Armend Zemaj, siç e dini, në ndryshim të Rregullores është punuar edhe në legjislaturën e kaluar, andaj lidhur me atë se në cilin draft do të punohet, kjo do ta diskutohet nesër në takim të Komisionit për Legjislacion, por ishte i mendimit që të fillohet me një punëtori.

Lidhur me këtë, Nënkomisioni, me propozim të z. Zemaj, vendosi që të mbahet një punëtori me dt. 11.11.2015, në orën 13:00.

4. Të ndryshme

Për këtë pikëtë rendit të ditës, nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj